

# INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKË

SEMPER VIGILE

> [IPK.RKS-GOV.NET](http://IPK.RKS-GOV.NET)






# INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKË

SEMPER VIGILE

> IPK.RKS.GOV.NET



**info**

zimp.ipk@rks-gov.net

Revista "Integriteti" është botim i Inspektoratit Policor të Kosovës

Divizioni për Marrëdhënie me Publikun dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

Botues: Inspektorati Policor i Kosovës

**Kryeredaktor:**  
Arber BEKA

**Ndihmës Redaktor:**  
Arben Vrajolli  
Albinë Ejupi

Tel: +383 (0) 44 146 696  
E-mail: arber.beka@rks-gov.net,  
arberbeka@gmail.com, zimp.ipk@rks-gov.net

**INTEGRITETI**

1. Policimi dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.....	4
2. IPK pjesë e operacionit të gjerë në Karaçevë dhe në rajone të ndryshme të Kosovës.....	6
3. Programi i besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut me Policinë e Kosovës.....	8
4. Analiza e përmbajtjes së informacionit në media dhe lajmet e rreme...11	
5. IPK monitoron nga afër policinë lidhur me zbatimin e vendimeve mbi zbatimin e masave parandaluese kundër përhapjes së Covid-19.....	12
6. Legjitimiteti dhe ligjshmëria e rasteve penale të trajtuara nga zyrtarët policor të dënuar për vepra penale të korrupsionit.....	14
7. Trajtimi i provave digjitale sfidë në hetimin e ditëve të sotme.....	17
8. 14 vjetori i IPK-se.....	18
9. OSBE përkrah realizimin disa punëtorive për krimet e urrejtjes .....	20
10. COVID-19 si pandemi globale sfidë reale edhe për Inspektoratin Policor të Kosovës.....	21
11. Misioni i OSBE-së përkrahu IPK-në me trajnim për analizimin e statistikave dhe të të dhënave .....	22
12. Dhurimi i gjakut nga IPK - gjest human në situatë pandemie.....	23



### PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të këtij botimi nuk paraqesin medeomos politikave ose vështrimet zyrtare të IPK-së.

PËRMBAJTJA

# Policimi dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut



dhe lirisë individuale nuk është diçka e re. Shpesh ky problem shprehet me terma të llogaridhënies. Quis custodiet ipsos custodes? (kush i ruan rojet?) ishte pyetja që parashtrohej në kohët e lashta. Sot, në kontekstin e demokracive liberale, përgjigjja ndaj këtij problemi të kamotshëm zakonisht shprehet në aspektin e llogaridhënies ndaj ligjit; megjithatë në Evropë, pajtueshmëria pritet jo vetëm me masat që merren në vend, por edhe me standardet evropiane dhe në veçanti me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Qytetarët evropianë - dhe ata që jetojnë brenda kufijve të shteteve evropiane - presin shumë nga shërbimet e tyre policore, por gjithashtu me të drejtë kërkojnë që administrimi i përgjegjësive policore të jetë në përputhje me ligjin dhe për më tepër të respektojë disa parime themelore që pasqyrojnë natyrën e shoqërisë demokratike. Ky „ligj“ nuk është vetëm ligj i vendit, por gjithnjë e më tepër një ligj evropian, i cili vetë shpreh 'vlerat' e caktuara në çështje të tilla si rëndësia e protestës demokratike, respektimi i jetës private të individëve dhe mbrojtja kundër zbatimit arbitrar të autoritetit policor.

Këto vlera shprehen në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me bazë në Strasburg. Detyra e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut është të japë udhëzime praktike përmes interpretimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe kur rastet vijnë para tij.

Roli i policisë në mbrojtjen e lirisë të individëve në komunitet përfshin sfida të posaçme. Në ruajtjen e sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike, ata që janë të ngarkuar me detyrën e policimit të shoqërisë, duhet të jenë subjekt i llogaridhënies para ligjit. Në një kuptim të vërtetë, zyrtarët policorë janë mbrojtësit e përditshëm të të drejtave të njeriut, por për të përmbushur këtë detyrë, ata shpesh duhet të ndërhyjnë në të drejtat e atyre që me vetëdije dëmtojnë të drejtat e të tjerëve.

Problemi i arritjes së një ekuilibri të përshtatshëm midis kompetencave të policisë



Këto raste përfshijnë fakte specifike të bazuara në sisteme individuale të së drejtës dhe praktikës vendore, por në themel të kësaj jurisprudence qëndrojnë parimet e caktuara që kanë zbatim universal. Për shembull, një rast që paraqitet në Turqi mund të ketë pasoja të mëdha për Francën ose për Mbretërinë e Bashkuar, si për shembull lidhur me qasjen në përfaqësimin ligjor gjatë kohës së paraburgimit në polici. Në të njëjtën mënyrë, një vendim që përfshin policimin e protestave në rrugë në Austri mund të ketë pasoja për zyrtarët policorë kudo në Evropë në lidhje me mënyrën se si policia merret me kundër-demonstruesit.

Policia e Kosovës si dhe Inspektorati Policor i Kosovës kanë pranuar një doracak që është botuar në kuadër të Programit të Përbashkët midis Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës me titull “Fuqizimi i luftës kundër keqtrajtimit dhe mosndëshkimit”, në kuadër të përpjekjeve për të rritur profesionalizmin e policisë dhe për përhapjen e standardeve të Këshillit të Evropës mbi policimin.


Qëllimi i këtij publikimi është të ndihmojë që t'u shpjegojë punonjësve të policisë ndikimin e standardeve kyçe, dhe në veçanti, ato dispozita ligjore detyruese të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të interpretuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ('Gjykata e Strasburgut'). Standardet e tjera evropiane theksojnë rëndësinë e përzgjedhjes, trajnimit dhe rritjes së ndjenjës së profesionalizimit nga ana e zyrtarëve policorë.


Ky doracak mëton të ndihmojë në zhvillimin e këtij mirëkuptimi dhe vetëdijesimi për përgjegjësitë e zyrtarëve policorë teksa mbrojnë shoqërinë. Policimi në mënyrë të pashmangshme përfshin ndërhyrje në të drejtat e njeriut të individëve, por a konsiderohen ndërhyrjet e tilla të arsyetuara apo a dënohen si shkelje të të drejtave të njeriut, shpesh nxit qasjen që merr zyrtari individual policor në

terren. Ky doracak do t'u ndihmojë zyrtarëve policorë të vënë në jetë qasjen e të drejtave të njeriut në punën e tyre të përditshme.

Doracaku është hartuar duke pasur parasysh Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, lidhur me praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit apo Ndëshkimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës (KPT) dhe standardet e tjera relevante që janë përcaktuar në kuadër të Këshillit të Evropës.

Në numrat e ardhshëm të revistës “Integriteti” do të sjellim përmbledhje nga ky doracak si një mjet i rëndësishëm në duart e policisë dhe të autoriteteve të tjera shtetërore për të parandaluar dhe luftuar sjelljen e pahijshme policore ose mosndëshkimin dhe për të ruajtur të drejtat e njeriut.





## Operacioni “Merimanga” vë në pranga mbi 60 të dyshuar

IPK realizoi suksesshëm operacionin e përbashkët në Karaçevë dhe në rajone të ndryshme të Kosovës

Pas incidenteve të shumta në kazino, e sidomos pas dy vrasjeve të ndodhura në këto objekte të lojërave të fatit, Kuvendi i Kosovës në mars të vitit 2019 miratoi ligjin që ndaloi lojërat e fatit. Ky ligj ishte propozuar nga Qeveria e Kosovës, kurse ishte miratuar në një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës.

IPK përmes rrjeteve sociale kishte pranuar informacionet e para në qershor të 2019-ës lidhur me dyshimet se në aktivitete të kundërligjshme ishin përfshirë edhe disa zyrtarë policorë, të cilët dyshohej se mundësonin që të zhvilloheshin lojërat e fatit por edhe kontrabanda me kafshë përmes rrugëve ilegale të cilat kalonin nëpër fshatrat e Kamenicës.

Krahas kësaj edhe Prokuroria e Shtetit kishte

pranuar informacione se në lokacione të ndryshme në Kosovë duke përfshirë këtu edhe Karaçevën, po luheshin ilegalisht lojërat e fatit bile edhe se ishte ngritur një lloj lagjeje ku kishte objekte të cilat dyshohej se funksionin si kazino në një zonë afër kufirit Kosovë - Serbi.

Bazuar në këto informacione si dhe në disa informacione që ishin bërë publike edhe në media, Prokuroria e Gjilanit së bashku me IPK-në kishte filluar hetimin që zgjati më shumë se një vit, e që në këtë hetim ishin inkuadruar edhe agjenci të tjera të zbatimit të ligjit.

Pas këtij hetimi, Prokuroria Themelore në Gjilan në bashkëpunim me zyrtarët e zbatimit të ligjit nga Inspektorati Policor i Kosovës, Policia e Kosovës dhe agjencitë tjera bashkëpunuese filluan ekzekutimin e urdhër-kontrolleve në





mbrëmjen e 18 shtatorit 2020 në fshatin Karaçevë, komuna e Kamenicës, në rajonin e Prishtinës, si dhe lokacione të tjera të vendit.

Operacioni filloi si rezultat i një hetimi të udhëhequr nga Prokuroria Themelore në Gjilan, lidhur me pretendimet për veprimtari të paligjshme, përfshirë bixhozin e paligjshëm, trafikimin me njerëz, trafikimin me armë, trafikimin me narkotikë, kontrabandimin e mallrave dhe aktivitete tjera kriminale.

Në operacionin e parë të zhvilluar u arrestuan më shumë se 30 persona të dyshuar, në mesin e tyre 12 zyrtarë policorë, të cilët brenda afatit ligjor u paraqitën para gjyqtarit të procedurës paraprake. Gjatë operacionit u sekuestruan aparate të lojërave të fatit, kafshë që dyshohej se ishin të kontrabanduara (kryesisht gjedhe), si dhe gjësende të ndryshme si prova materiale, që dyshohet të jenë përdorur në aktivitete kriminale.

Në një konferencë për medie që u mbajt ditën e nesërme pas operacionit nga zyrtarët e Prokurorisë së Gjilanit, IPK-së dhe PK-së u shpalosën detaje se "operacioni ka pasur për qëllim thyerjen e skemave piramidale, lokacioneve të dyshuara për prostitucion etj. Gjatë realizimit të operacionit u konfiskuan mbi 220 aparate të lojërave të fatit, shtëpiza kompjuteri, armë të ndryshme, kafshë të

kontrabanduara si dhe u shkatërruan 13 objekte ku dyshohej se ilegalisht zhvilloheshin lojëra të fatit por edhe veprimtari tjera të kundërligjshme.

Hetimi për këtë rast ishte zgjeruar edhe në pjesë të tjera të Kosovës. Bazuar në këtë, Prokuroria Themelore në Gjilan, Inspektorati Policor i Kosovës dhe Policia e Kosovës zhvilluan edhe një operacion tjetër në muajin tetor në rajone të ndryshme të Kosovës, përfshirë Gjilanin, Ferizajin, Prizrenin, Podujevën, Pejën, Suharekën dhe Vitinë. Ky operacion i cili ishte vazhdimësi e aksionit të Karaçevës rezultoi me arrestimin e personave të tjerë të cilët dyshohej se janë përfshirë në veprimtari kriminale duke përfshirë këtu edhe kontrabandimin me kafshë në mënyrë ilegale nga Serbia në Kosovë.

Hetimi kishte zbuluar se kafshët e kontrabanduara më pas përfundonin në thertore apo fabrika për prodhimin e mishit si në Gjilan, Prizren, Gjakovë, Suharekë, Podujevë, Prishtinë dhe të tjera vende.

Nga Prokuroria e Shtetit u konsiderua se kontrabandimi i kafshëve në një formë të tillë paraqet rrezik potencial për rrezikim të shoqërisë me dyshimin se ka pasur raste që janë kontrabanduar edhe gjedhe të sëmura të cilat në rast se konsumohen pa kontrolle mund të jenë të dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin e qytetarëve.

Angazhimi dhe hetimi në këtë rast, në dy operacione të mëdha ku u angazhuan qindra zyrtarë të agjencive të zbatimit të ligjit rezultoi me arrestimin mbi 60 të dyshuarve, konfiskimin e mbi 200 aparate të lojërave të fatit, armëve të ndryshme, kafshëve të kontrabanduara si dhe shkatërrimin e 13 objekteve ku dyshohej se ilegalisht zhvilloheshin lojëra të fatit por edhe veprimtari tjera të kundërligjshme.



# Programi i besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut me Policinë e Kosovës

*Misioni i OSBE-së përkrah PK-në dhe në jetësimin e këtij programi kurse IPK-në me trajnime për rëndësinë e monitorimit të programit për të siguruar dhe fuqizuar transparencën dhe llogaridhënien te policia*

Historikisht, Besueshmëria i publikut ka qenë veçanërisht e rëndësishme në Mbretërinë e Bashkuar, duke pasur parasysh origjinën e modelit policor britanik si policim me pëlqim. Nga nëntë parimet e zbatimit të ligjit, njëri është “gjatë gjithë kohës të mbahet një marrëdhënie me publikun që i jep realitet traditës historike që policia është populli dhe populli është policia”, gjersa policët janë thjeshtë anëtarë të publikut të cilët paguhen për t’i kushtuar vëmendje të plotë detyrave që i takojnë çdo qytetari në interes të mirëqenies dhe ekzistencës së komunitetit.

Policia shpeshherë mendohet të jetë “fytyra” e qeverisë kur është fjala për ndërveprimet e përditshme me qytetarët. Policia është manifestimi më i qartë i autoritetit qeveritar që kryen detyrat më të dukshme, të menjëhershme dhe ndërhyrëse për të siguruar mirëqenien e individëve dhe komuniteteve. Padyshim që Policia e Kosovës, që nga fillimi i saj më 1999, ka kaluar në një program të konsiderueshëm të reformës së policisë, me mbështetje të një numri donatorësh ndërkombëtarë.

Në vitin 2012, Policia e Kosovës (PK) ka miratuar konceptin e Policimit në Bashkësi, që kishte për qëllim përmirësimin e bashkëveprimeve të policisë me qytetarët. Përderisa janë realizuar

shumë qasje të ndryshme në reformën e policisë në kontekste të ndryshme, policimi në bashkësi përdoret shpesh në kur është fjala për krijimin e një partneriteti afatgjatë dhe të qëndrueshëm midis policisë dhe popullit.

Në vitin 2017, PK ka hartuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit të Policimit në Bashkësi (SPVPB) 2017-2021. Si prioritet i dytë i kësaj strategjie të Policisë së Kosovës ishte rritja e besueshmërisë të publikut dhe llogaridhënia e policisë dhe vlerësimi i procesit përmes anketave të zhvilluara me qytetarët. Për të qenë efektive në ruajtjen e publikut, mbajtja e besueshmërisë të publikut është kritike për çdo shërbim policor. Kjo është sepse publiku është burim kyç i informatave dhe se besueshmëria dhe bashkëpunimi i tyre është shpeshherë kyç për zbatimin e ligjit.

Besueshmëria dhe kënaqshmëria me policimin janë dy variabla të lidhura ngushtë dhe të ndërvarura që ofrojnë një pasqyrë më të qartë të perceptimit të publikut për shërbimin policor dhe nivelit të kënaqësisë me shërbimet e ofruara nga policia për komunitetin.





Shtytësit kryesorë të besueshmërisë të përmirësuar me policimin në komunitet përfshijnë angazhimin e publikut me policinë, trajtimin e drejtë, efektivitetin në trajtimin e krimit, trajtimin dhe zbutjen e sjelljeve antisociale lokale, trajtimin e problemeve lokale si shqetësimin ose frikën e përgjithshme nga krimi dhe informimin e qytetarëve mbi policimin lokal si një nga faktorët kyç të besueshmërisë të publikut.

Nuk është gjithmonë "krimi" ai që nxit pakënaqshmërinë e publikut me policinë dhe policimin. Anketat bashkojnë informatat mbi përvojat e njerëzve me krimin, sjelljet antisociale dhe kontaktet me policinë përmes një strukture më të qartë të pyetjeve që mundësojnë drejtimin e veprimeve për të sfiduar problemet me të cilat përballen njerëzit në zonat e tyre lokale.

Zhvillimet në policimin në sektor mëtojnë të rrisin shpeshësinë dhe përmirësojnë cilësinë e takimeve polici-publik, dhe të aspirojnë të rrisin besueshmërinë e publikut dhe ndjenjat e sigurisë. Nëse kontakti personal me policinë shoqërohet me nivele më të ulëta të besueshmërisë të publikut, atëherë nivelet e rritura të kontaktit mund të çojnë në ulje të nivelit të besueshmërisë.

Janë me të vërtetë disa arsye për të sugjeruar se ka më shumë ndikime negative nga përvoja personale sesa pozitive, andaj kontakti në përgjithësi dëmton besueshmërinë. Këto kryesisht përqendrohen në rolin e veçantë dhe veçanërisht të vështirë të policisë. Policia para publikut është edhe shërbim edhe agjenci e zbatimit të ligjit, i cili në thelb, është rrallëherë i aftë t'u ofrojë atyre rezultate konkrete. Më saktësisht një numër relativisht i vogël i përballjeve me policinë të iniciuara nga viktimat e krimit do të rezultojnë favorshëm, me



ndëshkime të shqiptuara ndaj kryerësit (arrestim ose ndjekje penale) ose kthim të pasurisë së vjedhur. Personat që ndalen nga oficerët policorë, qoftë në këmbë qoftë në automjete së paku do të përjetojnë një shqetësim. Kënaqshmëria e qytetarëve me policinë i referohet vlerësimit të punës së policisë pas një përvoje të drejtpërdrejtë në cilësinë e viktimës së krimit. Në këtë kuptim, kënaqshmëria e qytetarëve është e nxitur nga parandalimi i krimit dhe reagimi efektiv dhe me kohë i policisë, trajtimi i drejtë si dhe lehtësia e përgjithshme e kontaktit mes qytetarëve, policisë dhe hetuesve. Pra ata e shqyrtojnë atë se sa seriozisht po e trajton policia krimin ndaj tyre, sa të informuar ndihen për përparimin e shënuar në hetim dhe sa të sigurt ndihen se nuk të jenë prapë viktimë e krimit. Me qëllim të forcimit të besimit dhe kënaqshmërisë të publikut në Kosovë, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë (OSBE) zhvilloi një studim pilot në një përpjekje për të monitoruar besimin e publikut në Policinë e Kosovës (PK) dhe nivelet e kënaqësisë të viktimave të krimit me shërbimin policor që kanë marrë. Para kësaj, OSBE-ja ka zhvilluar, zbatuar dhe monitoruar programin pilot të besueshmërisë dhe kënaqshmërisë në stacionin policor të Ferizajit gjatë vitit 2016. Programi përfshiu trajnimin dhe këshillimin e PK-së në ofrimin e një shërbimi të avancuar, hartimin dhe shpërndarjen e pakove për viktimat e krimit dhe materialin për ngritjen e vetëdijes për një publik më të gjerë, viktimat e krimit dhe ata që kishin kontakt të drejtpërdrejtë me PK.

Qëllimi ishte të zgjerojë aftësinë e PK-së për të ofruar një shërbim të përmirësuar për viktimat e krimit, duke rritur kështu besimin dhe kënaqësinë e komunitetet me policinë.

OSBE-ja fillimisht i njoftoi menaxherët e lartë të PK-së me konceptin dhe filozofinë pas adoptimit të një qasjeje të përqendruar tek viktimat në polici dhe u siguroi atyre një përmbledhje të programit që do të pilotohej në një stacion policor të Ferizaj. Pas kësaj, më shumë se 120 oficerë nga të gjitha njësitë që punojnë në Stacionin Policor Ferizaj u trajnuan në ofrimin e një niveli të përmirësuar të shërbimit për viktimat e krimit, dhe në rritjen e nivelit të kënaqësisë së publikut dhe besimin e tyre në polici. Ata gjithashtu u njohën dhe u pajisën me materiale për viktimat e krimit të hartuara posaçërisht nga OSBE, për t'u shpërndarë më tej viktimave të krimit. Pjesëmarrësit gjithashtu mësuan për rëndësinë e komunikimit dhe ndërveprimit me viktimat, si dhe me rolet dhe përgjegjësitë e mbikëqyrësve, hetuesve dhe menaxhmentit për të përmirësuar besimin e përgjithshëm.

Gjatë vitit 2017 misioni i OSBE mbështeti Policinë e Kosovës në zbatimin e Strategjisë së tyre të Policisë në Bashkësi dhe Planit të Veprimit 2017-2021. Fokusi kryesor i aktiviteteve ka qenë rreth përgatitjeve të mëtejshme dhe rritjes së kapaciteteve të PK-së në të gjitha nivelet për të zgjeruar Programin e besueshmërisë dhe kënaqshmërisë (PBK) në të gjithë PK-në.

Programi 2017 përfshiu organizimin e punëtorive për menaxherët e mesëm dhe të lartë në të gjitha rajonet e PK-së përfshirë policinë kufitare. Gjatë vitit 2018 theksi i aktiviteteve të programit ka qenë rreth ndihmës së PK-së për të zhvilluar një sistem monitorimi dhe menaxhimi për të plotësuar PBK-në, në mënyrë që të ndihmojë PK-në në orientimin e saj përtej përmirësimit të qasjes ndaj viktimave të krimit. Në këtë drejtim, Misioni mbështeti PK-në me një punëtorie për të finalizuar Udhëzuesin për Zbatimin dhe Monitorimin e Programit të besueshmërisë dhe kënaqëshmërisë. Dokumenti i finalizuar përmban një sërë mjetesh praktike dhe udhëzimesh për PK-në se si praktikisht të zbatojë dhe monitorojë programin e besueshmërisë dhe kënaqëshmërisë brenda policisë. Duke ndjekur procesin dhe zgjerimin e programit në të gjithë PK-në, OSBE realizoi nëntë punëtori një-ditore për shefat e sektorit të policisë dhe menaxhimin e linjës së parë ku morën pjesë mbi 300 zyrtarë policorë të niveleve të ndryshme.

Objektivi i vitit 2019 synonte të siguronte vazhdimin e përpjekjeve të përbashkëta për të zgjeruar me sukses zbatimin praktik të besueshmërisë dhe kënaqëshmërisë. Përmes këtij projekti, Misioni mbështeti PK-në për të ndryshuar në mënyrë efektive stilin e tyre të menaxhimit. Projekti mbështeti PK-në për të futur sistemin e monitorimit dhe menaxhimit të Programit të besueshmërisë dhe kënaqshmërisë (PBK) në kategori të ndryshme të stafit menaxhues të PK-së. Në këtë drejtim, Misioni lehtësoi pesë punëtori rajonale për të prezantuar udhëzuesin për zbatimin dhe monitorimin PBK-së në polici. Theks i veçantë gjatë këtyre sesioneve u është kushtuar roleve dhe përgjegjësi të hetuesve dhe menaxherëve të policisë, ku udhëzime dhe këshilla specifike se si të zbatohet në mënyrë praktike dhe të monitorohet programi iu ofruan oficerëve të policisë dhe niveleve të ndryshme të stafit drejtues nga të gjitha departamentet dhe rajonet të policisë. Për më tepër, Misioni i OSBE realizoi punëtori të specializuara për Programin e Besueshmërisë dhe Kënaqshmërisë për njësitë përkatëse të PK-së. Misioni po ashtu mbështeti PK-në në lehtësimin e tre punëtorive për oficerët e departamentit të hetimit dhe njësitet rajonale të hetimit për më shumë se 100 hetues ku u shpjegua një përmbledhje e detajuar të kërkesave dhe përfitimeve përmes zbatimit të suksesshme të Programit të Besueshmërisë dhe Kënaqshmërisë.

Misioni i OSBE-së e përkrahu edhe Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), duke realizuar trajnimin tre ditor të zyrtarëve të Inspektoratit Policor të Kosovës për monitorimin e besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut me Policinë e Kosovës.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të zhvillohen dhe përmirësohen aftësitë e inspektorëve të IPK-së në monitorimin e performancës së PK-së gjatë ofrimit të shërbimeve publike, dhe për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien e zyrtarëve të PK-së në të gjitha nivelet. Po ashtu, qëllimi i këtij aktiviteti përmes realizimit të këtij trajnimi të specializuar, ishte të zhvillojë kapacitetet e IPK-së për të monitoruar programin e besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut me Policinë e Kosovës.



# *Analiza e përmbajtjes së informacionit në media dhe lajmet e rreme*

Zyrtarët e komunikimit të agjencive të zbatimit të ligjit përkrahen nga OSBE me trajnim për analizën e përmbajtjes së informacionit në media dhe lajmet e rreme

Fuqizimi i transparencës mbetet një ndër prioritetet e vazhdueshme në secilën agjenci të zbatimit të ligjit në vendet demokratike. Kjo llogaritet të jetë edhe llogaridhënie për qytetarët për veprimet e ndërmarra bazuar në autorizimet e veçanta të secilës agjenci.

Krahas kësaj, edhe mediet luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e qytetarëve për dukuritë e ndryshme në shoqëri duke përfshirë këtu edhe gazetarinë hulumtuese që shpesh publikimet e natyrës së tillë përbëjnë bazë për inicimin e hetimeve sipas detyrës zyrtare nga institucionet e vendit.

Me zhvillimin e medieve të ndryshme, sidomos atyre online, është bërë sfiduese që të përcillen/monitorohen të gjitha lajmet e publikuara në lidhje me sigurinë. Krahas përcjelljes së tyre, pa dyshim që analiza e përmbajtjes së informacionit të publikuar është me interes të veçantë për agjencitë e sigurisë.

Për të ndihmuar zyrtarët e agjencive të sigurisë në këtë drejtim, Misioni i OSBE-së mbajti një trajnim për analizën e përmbajtjes së medieve për zyrtarët e komunikimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, Policisë së Kosovës, Inspektoratit Policor të Kosovës, Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Trajnimi u përqendrua në analizën e përmbajtjes së informacionit në lidhje me sigurinë e postuar në mediet online dhe platformat e medieve sociale.

Gjatë trajnimit, zyrtarët e komunikimit u njohën me një sasi të madhe të medieve dhe përmbajtjes së gjeneruar nga përdoruesit të shpërndarë në forma të ndryshme si Facebook, Instagram, Twitter, blogje dhe të tjera, të cilat janë analizuar duke përdorur një sërë teknikash të përcaktuara qartë.

Pjesëmarrësit gjithashtu u njohën me një numër metodash për të identifikuar lajmet e rreme, duke përdorur platforma të ndryshme në internet që mund të përdoren për të vlerësuar vërtetësinë e informacionit dhe besueshmërinë e burimeve.

Në fund të trajnimit, pjesëmarrësit dhe trajnerët së bashku zhvilluan një metodologji praktike të analizës së përmbajtjes bazuar në nevojat e institucioneve për monitorimin e mediave në internet.





**IPK monitoron nga afër policinë lidhur me zbatimin e vendimeve mbi zbatimin e masave parandaluese kundër përhapjes së Covid-19**

*Monitorim që i kontribuon ngritjes së përgjegjësisë në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme policore*

Situata epidemiologjike me Covid-19 në Kosovë gjatë muajve të verës nga Qeveria e vendit konsiderohej shumë serioze dhe kjo kishte ndikuar që të ndërmerren masa kundër përhapjes së pandemisë.

Masat e reja përveç tjerash përfshinin edhe ndalimin e qarkullimit të personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në disa qytete të Kosovës duke bërë përjashtim për rastet urgjente shëndetësore.

Me këto masa parashihej që institucionet publike dhe private të reduktojnë numrin e të punësuarve vetëm në nivel të stafit të domosdoshëm.

Policia e Kosovës kishte filluar së zbatuari të planit operativ në zbatim të vendimeve të institucioneve kompetente, për parandalim të përhapjes së pandemisë COVID19 duke ndërmarrë në vazhdimësi veprime policore me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik. Policia e Kosovës po ashtu ishte duke koordinuar veprimet konkrete me inspektorët sanitarë duke u angazhuar me kapacitete të plota për realizimin e kufizimeve dhe rregullave që kishin vendosur institucionet në luftën kundër përhapjes së pandemisë.

Krahas këtyre angazhimeve shtesë të PK-së, në anën tjetër Inspektorati Policor i Kosovës kishte pranuar informacione nga burime të ndryshme se Policia e Kosovës nuk është duke zbatuar në përpikëri vendimet e dala nga Qeveria dhe se në disa raste po vepron në mënyrë selektive në raport me bizneset e qytetarët.

Bazuar në informacionet e tilla dhe nevojën që të kontribuohet në ngritjen e shërbimeve cilësore në kohë pandemie, IPK brenda përgjegjësisë dhe mandatit ligjor ka hartuar Planin Operativ për monitorimin e respektimit të vendimeve të Qeverisë së Kosovës mbi zbatimin e masave parandaluese kundër përhapjes së Covid-19.

Qëllimi i këtij monitorimi ishte që të përcaktohet nëse ligjet, rregulloret, vendimet dhe planet operative të Policisë së Kosovës zbatohen si duhet si dhe nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efikase në zbatimin e Vendimit të Qeverisë së Kosovës, nr. 01/17 (datë 28.07.2020) dhe Urdhrit Operativ për gatishmëri dhe reagim për Corona Virusin - Covid 19.







Synimi i këtij monitorimi ishte që të kontribuohet në ngritjen e përgjegjësisë në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme policore dhe të nxis seriozitetin e strukturës policore që të ndërmarrë hapat efikas në menaxhimin e situatës.

Gjatë përmbushjes së detyrës, IPK-ja ka aplikuar një metodologji të përshtatshme pune për të arritur objektivin e monitorimit, duke vëzhguar situatën në terren për të identifikuar dhe evidentuar ngjarjet dhe lokacionet dhe në rastet kur është hasur ndonjë lokal i hapura apo tubim i organizuara ka lajmëruar Policinë në numrin 192 dhe ka përcjell reagimin policor në thirrjet e bëra, duke iu shmangur kontaktit me qytetarë dhe zyrtarët policor, përveç situatave kur ka qenë e domosdoshme të kontaktohet me ta. Po ashtu, janë siguruar oraret ditore të aktivitetit policor në tërë territorin e vendit.

Bazuar në Planet operative të monitorimit, ky aktivitet është realizuar në katër (4) faza dhe ka përfunduar në shtator të këtij viti.

Monitorimi është fokusuar në kapacitetet policore të angazhuara, respektimin e zbatimit të masave të Qeverisë, si dhe bashkëpunimin me akterët tjerë të përfshirë në menaxhimin e situatës së krijuar nga Covid-19.

Ekipet e monitorimit kanë zhvilluar monitorimin bazuar në një varg ligjesh, vendimesh qeveritare dhe planesh operative dhe angazhimet e ekipeve të IPK-së gjatë realizimit të këtij plani kanë përfshirë edhe rekomandimet për suspendime për zyrtarë policorë në rastet kur ka pasur dyshime se nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme zyrtare .

# LEGJITIMITETI DHE LIGJSHMËRIA E RASTEVE PENALE TË TRAJTUARA NGA ZYRTARËT POLICOR TË DËNUAR PËR VEPRA PENALE TË KORRUPSIONIT

Sipas raportit të vjetor të Inspektoratit Policor të Kosovës për vitin 2019, gjatë këtij vit janë hetuar gjithsej tridhjetë e gjashtë (36) vepra penale të korrupsionit zyrtar. Prej tyre, njëzet e gjashtë (26) raste janë hetuar për shkak të dyshimit për “Keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar” dhe katër (4) raste të tjera për shkak të dyshimit për “Marrje të ryshfetit”. Nëse gjykata do të vërtetojë këto dyshime të arsyeshme përmes aktgjyqimeve të formës së prerë, kjo ndër të tjera do të nënkuptojë se këta persona të dyshuar/dënuar, gjatë kohës sa kanë qenë duke kryer detyrën zyrtare (p.sh. duke hetuar raste penale, duke ngritur kallëzime penale, duke pranuar ankesa të qytetarëve, etj), ata kanë keqpërdoruar në formë të ndryshme pozitën dhe autoritetin e tyre zyrtar përmes aferave të korrupsionit. Përtej gjykimit dhe shqiptimit të dënimit meritore sipas ligjit, dilema kryesore që shtrohet në këtë rast është se cili do të jetë statusi i rasteve që kanë trajtuar këta (ish) zyrtarë policor nëse ato raste janë të lidhura me veprën penale të korrupsionit për të cilën është dënuar (ish) zyrtari policor.

Për të shpjeguar plotësisht tematikën e këtij artikulli, do të përdoret një situatë hipotetike në të cilën zyrtari policor është duke zhvilluar hetimet penale për rastin “A” në koordinim me prokurorin e shtetit. Në ndërkohë Inspektorati Policor i Kosovës paraqet kallëzim penal për shkak të dyshimit se zyrtari policor e ka keqpërdorur detyrën zyrtare gjatë hetimit të rastit “A”. Në vijim, prokurori sipas këtij kallëzimi penal parashtron aktakuzë ndërsa gjykata me aktgjykim e shpall fajtor zyrtarin policor. Njëkohësisht me këto zhvillime, prokuroria e shtetit ka ngritur aktakuzë edhe për rastin “A” duke u bazuar plotësisht në kallëzimin penal që ka paraqitur zyrtari policor

(tani i dënuar për korrupsion). Dilema që shtrohet në këtë rast është nëse personat e interesuar në rastin “A” kanë të drejtë ose jo që të kontestojnë legjitimitetin dhe ligjshmërinë e rastit A dhe nëse po, cilat janë mundësitë e tyre për të realizuar këtë të drejtë?

Për të sqaruar këtë dilemë ka shumë rëndësi se deri në cilin stad ka arritur procedura penale lidhur me rastin “A” në momentin kur (ish) zyrtari policor është dënuar me aktgjykim të formës së prerë. Padyshim që në stad sa më të vonshëm që është procedura penale për rastin “A”, aq më të mëdha janë pasojat për viktimat e veprës penale të korrupsionit dhe e kundërta (vice versa). Nëse për rastin “A” nuk është shpallur ende aktgjykim përfundimtar, atëherë fakti që hetuesi i këtij rasti (ish-zyrtari policor) është dënuar për veprën penale të korrupsionit lidhur me rastin “A”, mund të propozohet si provë e re para gjykatës. Varësisht nga meritat e rastit “A”, gjykata mbi bazën e kësaj prove të re do të mund të nxirrte aktgjykim refuzues apo aktgjykim lirues për të akuzuarit (viktima potenciale të korrupsionit). Sidoqoftë janë mjaft të ulëta gjasat që rasti “A” i cili ka filluar para se të fillojnë hetimet për korrupsion kundër zyrtarit policor, të mbetet ende në shqyrtim gjyqësor ndërsa zyrtari policor të dënohet për veprën penale të korrupsionit pikërisht lidhur me rastin “A”.





Tutje, nëse lidhur me rastin "A" gjykata ka shqiptuar aktgjykim përfundimtar dhe njëkohësisht zyrtari policor dënohet për korrupsion lidhur me rastin "A", atëherë personat e interesuar mund të parashtrajnë ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike duke u bazuar në nenin 383 paragrafi 1 nën paragrafi 3 lidhur me nenin 386 paragrafi 3 dhe nenin 392 paragrafin 1 dhe 2 të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPK). Kuptohet që përmes ankesës do duhej të prezantohet si provë fakti i sapokrijuar për shkak të dënimit të zyrtarit policor. Në këtë situatë Gjykata e Apelit sipas nenit 398 paragrafit 1 nën paragrafit 4 do të ketë mundësinë që të ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore nga aktgjykimi dënues në aktgjykim lirues, duke marrë parasysh edhe efektet shtesë të ankesës të cilat janë Reformatio in Peius (neni 395, KPPK), Beneficium Cohesionis (neni 397, KPPK) si dhe efektet tjera shtesë (neni 396, KPPK).

Natyrisht se në situatat kur lidhur me rastin "A" gjykata ka shpallur aktgjykimin e formës së prerë, pasojat për personat e dënuar (viktimat e korrupsionit të zyrtarit policor) do të jenë vështirë të riparueshme! Sidoqoftë, vlen të theksohet që edhe në këto situata mund të parashtrohet kërkesë për rishikimin e procedurës penale në përputhje me nenin 423 paragrafi 1 nën paragrafi 2 të KPPK. Me rastin e shfrytëzimit të këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik, pala duhet të paraqes prova sipas të cilave aktgjykimi dënuar për të dënuarin në rastin A është rezultat i një veprë penale të korrupsionit që e ka kryer hetuesi policor i këtij rasti. Në këtë mënyrë gjykata do të mund të merr vendim për refuzimin e aktakuzës apo për lirimin nga akuzat kundër të pandehurit.

Cilindo opsion që do të shfrytëzoj viktimat e korrupsionit për të vendosur drejtësi në rastin "A", duhet shtuar se për realizimin e të drejtave të tij do të mund të kalojnë vite të tëra në sallat

gjyqësore të Kosovës qoftë për shkak të numrit të madh të rasteve, numrit të pamjaftueshëm të stafit apo arsyeve tjera për të cilat do të mund të zvarritej procedura gjyqësore. Padyshim që ato vite ai nuk do të mund të i kompensoj asnjëherë, as atëherë kur ndoshta gjykata e shkallës së tretë do të vendos në favorin e tij. Nga ky këndvështrim duhet theksuar se përtej aspektit të ligjshmërisë, është i kontestueshëm edhe legjitimiteti i atyre rasteve penale në kuadër të cilave hetuesit policor janë përfshirë në afera të korrupsionit. Nga ky kënd i vështrim, ndoshta duhet të ndryshohet/plotësohet KPPK në atë mënyrë që të përcaktohet se aktakuzat për korrupsion kundër zyrtarëve policor duhet të konsiderohen si çështje paraprake (res prejudicare) për procedurat penale lidhur me rastet që kanë të bëjnë aferën e korrupsionit për të cilën është ngritur aktakuza. Megjithatë ky konstatim mbetet vetëm një hipotezë e cila duhet hulumtuar me kujdes përmes një metodologjie të saktë shkencore. Për më tepër edhe po të vërtetohej kjo hipotezë, si e tillë do të shërbente vetëm për ato raste për të cilat aktakuza parashtrohet para se të përfundoj rasti tjetër i cili ka të bëjë me aferën e korrupsionit për të cilën është ngritur aktakuza. Rrjedhimisht dilema që mbetet është se si të veprohet në situatat kur aktakuza parashtrohet pasi që viktimat e korrupsionit të dënohet padrejtësisht me aktgjykim të formës së prerë!?

**Ndoshta numri i radhës të revistës "Integriteti" do të ndriçoj të vërtetën lidhur me këtë hipotezë dhe këto dilema, me ç' rast do duhej qetë merret në konsideratë edhe roli i prokurorit të shtetit si udhëheqës të hetimeve në Republikën e Kosovës.**



Përtej të drejtave që ka viktimat e korrupsionit në rastin A në kuadër të procedurës penale, vlen të theksohet se në Republikën e Kosovës nuk ekziston edhe një ligj i cili përcakton të drejtën e tij për mbrojtje civile nga korrupsioni përfshirë këtu edhe të drejtën për kompensimin e dëmit. Në fakt, neni 359 i Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet Detyrimore (LMD) përcakton vetëm se afati subjektiv për padi në rastet e korrupsionit është pesë (5) vite ndërsa afati objektiv është pesëmbëdhjetë (15) vite pas kryerjes së aktit.

Natyrisht se një përcaktim i tillë ligjor as për së afërmi nuk përkon me standardet e përcaktuara nga Konventa Civile kundër Korrupsionit e Këshillit të Evropës, pasi që nuk përcaktohen bazat e padisë, natyra juridike e padisë, procedurën për identifikimin e viktimës së korrupsionit, procedurën për kualifikimin dhe kuantifikimin e dëmit të korrupsionit dhe shumë standarde tjera që ka përcaktuar në këtë rast Këshilli i Evropës.

Për hir të së vërtetës, përveç LMD këto standarde nuk i përmbush as Ligji nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimin (LKVK) në të cilin as nuk përmendet fjala korrupsioni e lëre më shumë! Sidoqoftë sa i përket mbrojtjes civile të viktimave të korrupsionit në shtetin e Kosovës, përtej shumë zbrazëtirave ligjore që ekzistojnë (nëse krahasohemi me standardet e Këshillit të Evropës), dy (2) të drejta nuk mund të mohohen as në infrastrukturën ligjore aktuale: e drejta për të parashtruar padi për kompensimin e dëmit dhe e drejta për të shpresuar deri në fund për një vendim meritator, legjitim dhe ligjor!

**Adrianit Ibrahim, PhD(c)**  
Inspektorati Policor i Kosovës  
Divizioni për Planifikim dhe Çështje Ligjore



# Trajtimi i provave digjitale sfidë në hetimin e ditëve të sotme



## *Misioni i OSBE-së përkrahu IPK-në me trajnim për trajtimin e provave digjitale*

Pajisjet digjitale janë kudo në botën e sotme, duke i ndihmuar njerëzit të komunikojnë me lehtësi në nivel lokal dhe global. Shumica e njerëzve menjëherë mendojnë për kompjuterët, celularët dhe internetin si burimet e vetme për prova digjitale, por çdo pjesë e teknologjisë që përpunon informacionin mund të përdoret në mënyrë kriminale.

Për shembull, lojërat e ndryshme mund të mbajnë mesazhe të koduara mes të dyshuarve dhe madje edhe pajisje të reja shtëpiake, të tilla si një frigorifer me një TV të integruar, mund të përdoren për të ruajtur, shikuar dhe shpërndarë imazhe të paligjshme. E rëndësishme është që hetuesit duhet të jenë në gjendje të njohin, nxjerrin, sekuestrojnë dhe ruajnë siç duhet provat e mundshme digjitale.

Hetuesit e IPK-së u përkrahën në këtë fushë të rëndësishme me një trajnim nga Misioni i OSBE-së. Nga ana e IPK-së kjo u vlerësua si fuqizim i kapaciteteve në përputhje me trendet e zhvillimit të teknologjisë informative në rajon dhe më gjerë.

Ky trajnim u mbajt në objektin e IKAP-it (Instituti i Kosovës për Administratë Publike) në Hajvali për një javë rresht.

Këtë modul trajnimi e vijuan 15 zyrtarë të IPK-

së ku morën njohuri shtesë nga eksperti i fushës përkatëse nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë. Ky trajnim ishte hartuar për të rritur kapacitetet e IPK-së në ushtrimin efektiv të rolit mbikëqyrës ndaj policisë duke marrë njohuri shtesë në gjetjen, nxjerrjen, sistemimin dhe ruajtjen e provave digjitale në vendin e ngjarjes. Në fund të trajnimit në një ceremoni të organizuar nga IPK-ja u ndanë certifikata për pjesëmarrësit dhe prezent në këtë ceremoni ishin edhe U.D Kryeshefi i IPK-së z. Kushtrim Hodaj, Drejtori i Departamentit për Siguri Publike në Misionin e OSBE-së në Kosovë z. Edward Anderson etj.

Zyrtarët e IPK-së falënderuan edhe zyrtarët e IKAP-it për ofrimin e hapësirave për këtë trajnim në objektin e ri të tyre në Hajvali.



# IPK shënoi 14 vjetorin e themelimit

Fuqizimi i bashkëpunimit në mes IPK-së dhe qytetarëve do të ndihmojë Policinë në përmirësimin e shërbimeve të sigurisë që ofrojnë për publikun



Inspektorati Policor i Kosovës në një ceremoni të organizuar në Hajvali shënoi 14 vjetorin e themelimit.

Në këtë ceremoni ku morën pjesë kryesisht punonjës të IPK-së me numër të kufizuar të pjesëmarrësve për shkak të pandemisë, u ndanë mirënjohje dhe medalje për zyrtarë të IPK-së dhe bashkëpunëtorë vendor e ndërkombëtarë. U.D Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së z. Exhevit Zuka duke falënderuar të gjithë të pranishmit theksoi se rrugëtimi i IPK-së ndër vite ishte përplot sfida e suksese:

“Në përvjetorin e 14 të themelimit të IPK-së kujtojmë rezultatet dhe sfidat duke llogaritur edhe kontributin e secilit zyrtarë të IPK-së. Jemi të vetëdijshëm që IPK nuk e ka misionin e lehtë por ne do të vazhdojmë angazhimet tona drejt fuqizimit të integritetit policorë.”

Zuka potencoi se rrugëtimi i IPK-së deri në këtë fazë të sotshme u mundësua edhe nga

përkrahja e institucioneve vendore e ndërkombëtare siç është ICITAP-i amerikan dhe misioni i OSBE-së:

“Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë si ICITAP, OSBE-ja, dhe me përkrahjen e institucioneve vendore jemi angazhuar drejt zhvillimit profesional dhe ndërtimit të kapaciteteve të IPK-së. Falë këtij angazhimit dhe përkrahjeje që ne kemi pasur si institucion, dhe, falë dedikimit e përkushtimit të punonjësve të IPK-së kemi krijuar reputacionin dhe besueshmërinë që IPK-ja gëzon sot te qytetarët e Kosovës. Fuqizimi i bashkëpunimit në mes IPK-së dhe qytetarëve do të ndihmojë Policinë tonë në përmirësimin e shërbimeve të sigurisë që ofrojnë për publikun.







Ne do të punojmë shumë që këtë besueshmëri të qytetarëve të vendit ta ruajmë dhe ta fuqizojmë akoma më shumë” – theksoi z. Zuka duke vënë në pah se fuqizimi i bashkëpunimit në mes IPK-së dhe qytetarëve do të ndihmojë Policinë në përmirësimin e shërbimeve të sigurisë që ofrojnë për publikun.

Në shenjë mirënjohjeje për përkrahjen e dhënë në ngritjen e nivelit të profesionalizmit të IPK-së, mirënjohje u ndanë për zyrtarë të ICITAP-it, OSBE-së etj.

IPK u themelua në vitin 2006 si një mekanizëm i pavarur i mbikëqyrjes së Policisë me dy funksione kryesore: hetimin e të gjitha ankesave për sjellje të policëve, pa dallim grade apo pozite dhe inspektimi i mënyrës së kryerjes së detyrave nga ana e Policisë në një varg të definuar të funksioneve menaxhuese, në lidhje me saktësinë, efektshmërinë dhe zbatueshmërinë e ligjeve në fuqi.







## OSBE përkrah realizimin disa punëtorive për krimet e urrejtjes

IPK përmes Divizionit për bashkëpunim dhe informim dhe zyrtarëve të departamenteve tjera operative ka marrë pjesë si panelist në tetë punëtori të organizuara në Prishtinë, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Prizren, Pejë, Mitrovicë e Jugut, Gjakovë dhe Gjilan.

Këto punëtori u organizuan nga misionin e OSBE-së në Kosovë me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare rreth mbrojtjes së viktimave të mundshme të krimeve të urrejtjes. Pjesëmarrës në këto aktivitete kanë qenë anëtarët e Komiteteve Lokale për Siguri Publike (KLSP-ve), zyrtarë nga Zyra për ndihmë dhe mbrojtje të viktimave si dhe zyrtarë të Policisë së Kosovës. Këto punëtori janë në vazhdimësi e aktiviteteve për të ngritur vetëdijen e qytetarëve rreth të drejtave të tyre në mekanizma mbështetës të institucioneve

përkatese për mbrojtjen e viktimave respektivisht edhe Inspektoratit Policor të Kosovës. Gjatë punëtorive për pjesëmarrësit janë dhënë informacione edhe lidhur me misionin dhe fushëveprimin e IPK-së si dhe projekteve si atij të hapjes së zyrave rajonale, Linjës së Kaltër, procedimit të ankesave, hetimeve etj. Gjatë diskutimit të hapur në këto punëtori me anëtarët e KLSP-ve për fushëveprimin e IPK-së (rolin dhe autorizimet), u dhanë shpjegimet për ecurinë e procedurës hetimore në rastet që trajton IPK në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, ankesat dhe procedurat për trajtimin e tyre, inspektimet dhe roli i tyre në ngritjen e profesionalizmit të policisë dhe rëndësinë e integritetit policor.





# COVID-19 si pandemi globale sfidë reale edhe për Inspektoratin Policor të Kosovës



Shpërthimi i COVID-19 që është një sëmundje infektive mendohet të ketë një origjinë shtazore e shkaktuar nga sindromi i rëndë akut i frymëmarrjes koronavirus 2 (SARS-CoV-2), i cili filloi në nëntor ose dhjetor 2019 për herë të parë në Ëuhan të Kinës duke u përhapur globalisht dhe duke rezultuar në pandeminë e koronavirusit 2019-2020.

Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH) ka shpallur shpërthimin e koronavirusit 2019-2020 një pandemi dhe një Urgjencë e Shëndetit Publik të Shqetësimit Ndërkombëtar (PHEIC) Bazuar në këtë situatë dhe vendimet e Qeverisë së vendit, Inspektorati Policor i Kosovës hartoi "Planin e vijueshmërisë së punës gjatë Pandemisë Covid-19", në përputhje me rekomandimet e Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK).

IPK me qëllim të mbikëqyrjes dhe implementimit të "Planit të vijueshmërisë së punës gjatë Pandemisë Covid-19, në Inspektoratin Policor të Kosovës" fillimisht kërkoi furnizim me masa mbrojtëse nga Ministria e Shëndetësisë ku u pajis me maska, doreza dhe dezinfektues për duar. Po ashtu, furnizime me pajisje anticovid IPK ka pranuar edhe nga Ministria e Punëve të Brendshme si dhe donacion nga Ambasada Amerikane në Kosovë, ICITAP-i, misioni i OSBE-së në Kosovë etj..

Ndër masat e marra në përputhje me rekomandimet nga IKSHPK-ja ishte dezinfektimi i tërësishëm i objektit të IPK-së që u realizua me ndihmën e MPB-së dhe KFOR-t Italian, duke vendosur shenjat për respektimin e distancës dhe mbajtjes së maskave në të gjithë objektin, instalimi i aparateve për dezinfektim të duarve në hyrje të objektit si dhe në çdo hyrje të kateve përkatëse.

Vazhdimisht është bërë shpërndarja e maskave, dorezave dhe dezinfektuesve për stafin e IPK-së si dhe duke u kujdesur që të respektohet mbajtja e distancës.

Një përqindje e burimeve njerëzore të IPK-së si persona kontakti kanë qenë në vet izolim kurse një pjesë tjetër edhe është infektuar.

Duke pasur parasysh që sezoni vjeshtë-dimër krahas pandemisë rikthen edhe virusin e gripit sezonal, rezultatet e ditëve dhe javëve në vijim varen nga zbatimi i masave parandaluese nga qytetarët por në radhë të parë edhe nga vet zyrtarët e institucioneve shtetërore.

Në këtë drejtim të domosdoshme janë zbatimi i masave parandaluese të shëndetit publik ku bëjnë pjesë: distanca fizike, mbajtja e maskave sipas udhëzuesit të MSH-së, higjiena e duarve dhe shmangia e qëndrimit në vende ku ka grumbullim njerëzish.

Sjellja juaj në raport me pandeminë COVID-19 dhe zbatimi i masave parandaluese mund të jenë çelësi i parandalimit dhe luftimit të pandemisë.



# Misioni i OSBE-së përkrahu IPK-në me trajnim për analizimin e statistikave dhe të të dhënave



Në objektin e IPK-së në Hajvali për një javë rresht u mbajt trajnimi i përkrahur nga misioni i OSBE-së për analizimin e statistikave dhe të të dhënave.

Këtë modul trajnimi e vijuan 15 zyrtarë të IPK-së ku morën njohuri shtesë nga eksperti i fushës përkatëse.

Ky trajnim ishte hartuar për të rritur kapacitetet e IPK-së në ushtrimin efektiv të rolit të tij mbikëqyrës ndaj policisë duke marrë njohuri shtesë në analizën e statistikave. Në fund të trajnimit në një ceremoni të organizuar nga IPK-ja u ndanë certifikata për pjesëmarrësit dhe prezent në këtë ceremoni ishin edhe U.D Kryeshefi i IPK-së z. Exhevit Zuka, Drejtori i Departamentit për Siguri dhe

Rend Publik në Misionin e OSBE-së në Kosovë z. Edward Anderson etj.

Zuka falënderoi zyrtarët e misionit të OSBE-së për përkrahjen e dhënë drejt ngritjes së kapaciteteve të IPK-së duke potencuar se përkrahja e OSBE-së për IPK-në ka filluar me trajnimin e gjeneratave të para në IPK:

“Falë këtij angazhimit dhe përkrahjeje që ne kemi pasur si institucion, dhe, falë dedikimit e përkushtimit të punonjësve të IPK-së kemi krijuar reputacionin dhe besueshmërinë që IPK-ja gëzon sot te qytetarët e Kosovës pas 14 vjetëve të themelimit” theksoi ndër të tjera z. Zuka.

Në këtë ceremoni, mirënjohje për përkrahjen e vazhdueshme të OSBE-së iu dha edhe Drejtorit të Departamentit për Siguri Publike - z. Edward Anderson.





# Dhurimi i gjakut nga IPK - gjest human në situatë pandemie

*Zyrtarët e IPK-së edhe këtë vit me aksion të dhurimit vullnetar të gjakut*



Zyrtarët e Inspektoratit Policor të Kosovës dhuruan vullnetarisht gjak në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

IPK në këtë mënyrë iu përgjigj kërkesës së Qendrës Kombëtare për Transfuzion të Gjakut në lidhje me mungesën e dozave të gjakut në situatë pandemie.

Aksioni humanitar i dhurimit të gjakut u realizua në bashkëpunim me Divizionin e Burimeve Njerëzore në IPK dhe Qendrën Kombëtare për Transfuzion të Gjakut në Prishtinë. Gjatë këtij aksioni një ditë janë

dhuruar 13 doza gjak, për nevojat e Qendrës së Transfuzionit të Gjakut.

U.D Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës z. Exhevit Zuka gjatë vizitës së tij tek punonjësit që dhuronin gjak u shpreh i kënaqur që IPK ka vijuar shembullin e mirë për dhurimin e gjakut:

“Dhurimi i gjakut është një sakrificë por më shumë është gjest human, fisnik dhe ndihmë e madhe për të gjithë ata qytetarë që kanë nevojë për gjak, sidomos në këtë situatë pandemie”, tha z. Zuka.





INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA  
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO



**NËSE MENDONI SE U JANË SHKELUR TË DREJTAT TUAJA  
NGA ZYRTARËT POLICORË, RAPORTONI NË *LINJËN E KALTËR*:  
AKO MISLITE DA SU VAQ A PRAVA PREKRQENA OD STRANE POLICAJACA  
POZOVITE NA *PLAVU LINIJU*:  
IF YOU THINK YOUR RIGHTS WERE VIOLATED BY POLICE OFFICIALS,  
REPORT IN *BLUE LINE*:**

**RAPORTONI PA PAGESË  
IZVESTI BESPLATNO U  
FREE OF CHARGE**



**080003333**

**Së bashku për një polici profesionale  
Zajedno za profesionalnu policiju  
Together for professional police**

IPK SIGURON KONFIDENCIALITET TË PLOTË NË TRAJTIMIN E INFORMACIONEVE  
PIK OSIGURAVA POTPUNU TAJNOST U TRETIRANJU INFORMACIJAMA  
PIK OFFERS FULL CONFIDENTIALITY IN TREATING THE INFORMATION